

VENDIM
Nr.1213, datë 27.8.2008

**PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË
BRAZILIA, BRAZIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 15, të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në Brazilia, Brazil.
 2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie do të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.
 3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha